

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ED Partners” SH.P.K

Sot me datë 07.02.2024, në Tiranë në mbështetje të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, u hartua ky akt themelimi nga ortakët themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga Z. Dition Hoxha , Z. Ervis Bajraktari , Znj. Sara Bajraktari si më poshtë vijon:

NENI 1
THEMELIMI DHE EMRI I SHOQËRISË

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“ED Partners” SH.P.K.**
Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Aktin e Themelit dhe Statutin e saj.

NENI 2
SELIA


Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga Muhamed Gjollësja, Pallati Moskat 2 sh 3, Kati 1, Ap 13, Tiranë dhe mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të asamblesë së ortakëve.

NENI 3
FORMA

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Depo farmaceutike, import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice të barnave (për përdorim human dhe veterinar) kozmetike, bime mjekesore, pajisjeve dhe aparaturave mjekesore, mjeteve dhe materialeve ndihmese mjekesore. Import dhe eksport për tregtim me shumice dhe pakice të mallrave industriale, makinerive, pajisjeve dhe impjanteve të ndryshme farmaceutike dhe stomatologjike, instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import dhe eksport për tregtim me shumice dhe pakice të artikujve të ndryshëm kozmetike. Import dhe eksport për tregtim me shumice dhe pakice, montim, mirembajtje dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekesore, impianteve dhe aksesoreve të tyre si dhe çdo lloj produkti tjetër që konsiderohet i dobishëm për aktivitetin e shoqërisë. Farmaci, përgatitje farmaceutike. Tregtim me pakice të artikujve kozmetike, barnave, integrotoreve dhe ushqimeve për fëmijë. Tregtim online i integrotoreve, produkteve dermo-kozmetike, materiale mjekesore, produkte për fëmijë. Investime, shërbime, projekte në fushën e mjekësisë dhe shëndetësisë. Shoqëria mund të kryejë aktivitetin e publikimeve dhe reklamimeve.



NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar (e pacaktuar), duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznësit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të asamblesë së ortakëve,

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët e shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakëve .

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Ortakëve të Shoqërisë :

- Z. Dition Hoxha , zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 50.000 (Pesëdhjetëmijë) lekë.
- Z. Ervis Bajraktari , zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 25.000 (Njëzetëepesëmijë) lekë.
- Znj. Sara Bajraktari , zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 25.000 (Njëzetëepesëmijë) lekë.

ORGANI DREJTUES

NENI 7 ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e Ortakëve zotëron të gjitha kompetencat që i njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

NENI 8 ADMINISTRATOR

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Dition Kujtim Hoxha, i datëlindjes 22.03.1988, zotërues i kartës së identitetit me nr personal I80322008P.



NENI 9 FITIMI

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë.

NENI 10 BILANCI

Viti financiar fillon në 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet hartuara nga



eksperti kontabel, miratohen nga asambleja e ortakëve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 11 KONFLIKTET

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas statutit të shoqërisë, kontratës të lidhur me palët dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar.

NENI 12 VULA DHE SHENJA DALLUESE

Shoqëria ka vulën dhe shenjat e veta dalluese.

NENI 13

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas marrjes së lejes nga organet kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit u perpilua në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË

Dition HOXHA

Dition Hoxha

Ervis BAJRAKTARI

ERVIS BAJRAKTARI

Sara BAJRAKTARI

SARA BAJRAKTARI